

**LIGJI NR. 06/L -105****PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE****KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj vendos dhe rregullon sistemin e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, në territorin e Republikës së Kosovës.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës (tash e tutje ATK) dhe për të gjithë personat në fushëveprimin e këtij ligji.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Për qëllime të këtij ligji përkufizimet në vijim kanë këtë kuptim:

**1.1. Pasuri kapitale – përfshinë:**

1.1.1. pasuri e prekshme apo e paprekshme që kushton më shumë se një mijë (1,000) Euro me afat të përdorimit më të gjatë se një (1) vit;

1.1.2. pasuria, vlera e së cilës është deri në njëmijë (1,000) Euro, e cila nuk mund të funksionojë si e vetme, trajtohet si pasuri kapitale, nëse vlera e tërësisë kalon mbi njëmijë (1,000) Euro.

1.2. **Entitet** - Korporatë ose organizatë tjetër afariste që e ka statusin e personit juridik, organizatë afariste që vepron me mjetet në pronësi publike dhe shoqërore, organizatë joqeveritare e regjistruar sipas legjislacionit mbi regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë dhe njësia e përhershme e personit jo rezident;

1.3. **Korporatë** – person juridik, i cili ka një identitet që është i ndarë dhe dallon nga anëtarët, pronarët dhe aksionarët. Një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në numër të specifikuar të aksioneve të së njëjtës vlerë nominale. Aksionarët nuk janë të detyruar për obligimet e korporatës. Një korporatë mundet të jetë qoftë kompani aksionare apo kompani me përgjegjësi të kufizuar, e cila është treguar në diagramin e vet të ekonomisë apo emrin e kompanisë;

1.4. **Dividendë** - shpërndarje e bërë nga një kompani për një aksionar, si vijon:

1.4.1. në para të gatshme ose aksione në bazë të pjesës së interesit të aksionarit në kompani, dhe

1.4.2. pronë tjetër, pos parave të gatshme ose e aksioneve, përveç nëse shpërndarja bëhet si rezultat i likuidimit.

1.5. **Aktivitet ekonomik** - çdo aktivitet i prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra ose shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, si dhe aktivitetet e profesioneve. Eksploatimi në baza të vazhdueshme i pasurive të prekshme dhe paprekshme me qëllim të sigurimit të të ardhurave në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik;

1.6. **Pasqyrë financiare** - pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me legjislacionin përkatës për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;

1.7. **E ardhura me burim në Kosovë** - e ardhura bruto që krijohet në Kosovë;

1.8. **E ardhura nga burimi i jashtëm** – e ardhura bruto që nuk është e ardhur me burim në Kosovë;

1.9. **E ardhura bruto** - të ardhurat e fituara ose të akumuluar, përfshirë mes tjerash, të ardhurat nga veprimtaritë e prodhimit, tregtisë, financave, investimeve, veprimtarisë profesionale ose veprimtarive të tjera ekonomike;

1.10. **Pronë e prekshme** – paratë e gatshme, pajisje, makineri, uzinë, pronë – çdo gjë që ka ekzistencë afatgjate fizike apo është përvetësuar për shfrytëzim në operimet e biznesit dhe jo për shitje për klientët. Në bilancin e gjendjes të biznesit, pasuritë e tilla përgjithësisht janë të listuara nën kapitullin “Uzina dhe pajisja” apo “Uzina, prona dhe pajisja”;

1.11. **Pronë e paprekshme** - patentat, të drejtat e autorit, licencat, të drejtat ekskluzive dhe prona tjetër që përbëhet vetëm nga të drejtat, por që nuk ka formë fizike;

1.12. **Vlerë e hapur e tregut** - nënkupton shumën e plotë që duhet ta paguaj konsumatori në shkallën e njëjtë të tregut në të cilin ndodh furnizimi i mallrave ose shërbimeve, nën kushtet e konkurrencës së barabartë, për furnizuesin nën mbizotërimin e tregut brenda Kosovës ku është bërë furnizimi, në mënyrë që të marr mallrat ose shërbimet në fjalë në atë moment. Kur nuk mund të sigurohet krahasimi për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, vlera e hapur e tregut nënkupton, si në vijim:

1.12.1. në lidhje me mallrat, një shumë që nuk është më e vogël se çmimi i blerjes së mallrave ose të mallrave të ngjashme, ose në mungesë të çmimit të blerjes, çmimi i koston i përcaktuar në kohën e furnizimit;

1.12.2. në lidhje me shërbimet, një shumë që nuk është më e vogël se kostoja e plotë e personit të tatueshëm që e ofron atë shërbim.

1.13. **Rezident** - nënkupton:

1.13.1. një person fizik i cili ka një vendqëndrim kryesor në Kosovë ose fizikisht është i pranishëm në Kosovë mbi njëqind e tetëdhjetë e tre (183) ditë në çdo periudhë kohore dymbëdhjetë (12) mujore; apo

1.13.2. një entitet, ndërmarrje afariste personale, ortakëri, apo shoqëri e

personave e cila është themeluar në Kosovë.

1.14. **Jo rezident** - çdo person ose entitet që nuk është rezident i Kosovës;

1.15. **Njësia e përhershme** - nënkupton personin jo rezident, i cili bëhet subjekt i tatuarjes për Tatim në të Ardhura të Korporatave në Kosovë, ashtu siç është e përkrahur në nenin 30 të këtij ligji;

1.16. **Person** - përfshin:

1.16.1. Person fizik –konsiderohet:

1.16.1.1. personi fizik jo afarist (që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi); dhe

1.16.1.2. personi fizik afarist (që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt biznesor).

1.16.2. Person juridik - shoqëri tregtare e themeluar sipas legjislacionit përkatës për Shoqëritë Tregtare, person tjetër i themeluar sipas këtij legjislacioni, i cili ushtron veprimtari fitimprurëse në Republikën e Kosovës, si dhe person tjetër i themeluar ose i njohur si i tillë me ligj të veçantë;

1.16.3 Ortakëri –përfshinë:

1.16.3.1. një ortakëri të përgjithshme, ortakëri të kufizuar apo përmes marrëveshjeve të ngjashme që nuk është person juridik dhe që në mënyrë proporcionale ndanë pjesët e kapitalit, të të ardhurave dhe humbjes në mes të ortakëve; dhe

1.16.3.2. një grupim apo shoqëri të personave, përfshirë konsorciumet, por duke i përjashtuar ortakëritë, të themeluara për një qëllim të përbashkët të një aktiviteti ekonomik të veçantë. Shoqëria përbëhet prej dy apo më shumë individë, kompani, organizata, apo qeveri, apo çdo kombinim i këtyre entiteteve me qëllim të pjesëmarrjes në një aktivitet të përbashkët apo grupim i burimeve të tyre për arritjen e një qëllimi të përbashkët. Secili pjesëmarrës mban statusin juridik të vetin të ndarë dhe kontrolli i shoqërisë mbi secilin pjesëmarrës është përgjithësisht i kufizuar në aktivitetet që përfshin përpjekjen e përbashkët, në veçanti ndarjen e fitimeve. Shoqëria themelohet nga një kontratë, e cila përcakton të drejtat dhe obligimet e secilit anëtar.

1.17. **Autoritet publik** - autoriteti qendror, lokal, organ publik, apo ndonjë autoritet tjetër që ushtron pushtet publik ekzekutiv, ligjvënës, rregullator, administrativ ose pushtet gjyqësor;

1.18. **Personat e lidhur** - persona me lidhje të veçanta që mund të ndikojnë materialisht në rezultatet ekonomike të transaksioneve ndërmjet tyre. Personat konsiderohen se kanë lidhje të veçanta nëse:

1.18.1. janë zyrtarë ose drejtorë të bizneseve të njëri - tjetrit;

1.18.2. janë partnerë të ligjshëm në biznes;

1.18.3. kanë lidhje punëdhënës- punëmarrës;

1.18.4. një person që mban ose kontrollon pesëdhjetë për qind (50%) a më

shumë të aksioneve ose të drejtën e votës në personin tjetër juridik;

1.18.5. njëri prej tyre drejtpërsëdrejti ose tërthorazi e kontrollojnë tjetrin;

1.18.6. që të dy drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kontrollohen nga një person i tretë;

1.18.7. kur personat janë të afërm të radhës së parë, të dytë dhe të tretë, të specifikuar sipas Ligjit mbi Trashëgiminë të Kosovës;

1.18.8. kur personat janë anëtar të grupit të njëjtë të kompanisë shumëkombëshe, që nënkupton që secila kompani mëmë, degë dhe nëndegë janë të lidhura me të tjerat.

1.19. **Periudha tatimore** - viti kalendarik ose çdo periudhë tjetër e raportimit e paraparë me këtë ligj;

1.20. **Pasuria e patundshme** - për qëllime tatimore, e tërë toka dhe ndërtesat apo strukturat nën dhe mbi sipërfaqen tokësore dhe të lidhura me tokën, përfshirë pasurinë që është shtesë (ndihmëse) në pasurinë e patundshme; të drejtat në të cilat aplikohen dispozitat e ligjit të përgjithshëm që respekton pasurinë tokësore; uzufuktin e pasurisë së patundshme; dhe të drejtat në pagesat e ndryshueshme dhe të fiksuara si konsideratë për punimin apo të drejtën për të punuar, vendburimin mineral, burimet dhe rezervat tjera natyrore;

1.21. **E drejta pronësore** - pagesa e çdo lloji të pranuar si një konsideratë për shfrytëzimin apo të drejtën e shfrytëzimit, të çdo të drejte të autorit të punës letrare, artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografik, dhe patentat, emrin tregtar, dizajn apo plan modelin, formulë apo proces sekret, apo për informatat që lidhen me përvojën industriale, komerciale apo shkencore;

1.22. **Furnizues** - për aspekte të lizingut financiar është personi i cili në bazë të kontratës së furnizimit që lidh me qiradhënësin për pasurinë e përzgjedhur nga qiramarrësi në përputhje me përcaktimet e qiramarrësit dhe me kushtet e miratuara prej tij, me anë të së cilës qiradhënësi fiton të drejtën e pronësisë mbi atë pasuri, i shet qiradhënësit pasurinë që i jepet me qira qiramarrësit;

1.23. **Bashkësitë fetare** - të parapara me Ligjin për Lirinë Fetare në Kosovë;

1.24. **Lizingu operues** – çdo lizing që nuk është lizing financiar;

1.25. **Lizing financiar** – një lizing që transferon në mënyrë substanciale të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e rastit për pronësinë e një artikulli të pasurisë. Titulli mundet ose nuk mundet të transferohet në fund të lizingut;

1.26. **Nën-kontraktor** - çdo person që kryen një pjesë të një projekti tërësor që është marrë nga kontraktori kryesor. Nënkontraktori është drejtpërdrejt i angazhuar në ekzekutimin dhe realizimin e projektit tërësor dhe vepron në interes të kontraktorit kryesor. Periudha e kaluar nga nënkontraktori që punon në një projekt gjithëpërfshirës konsiderohet si kohë e kaluar nga kontraktori kryesor në projekt;

1.27. **Kontraktori kryesor/ Kontraktor** – çdo biznes, qoftë organizatë apo individ, i cili është pajtuar të kryejë operimet nën çdo dokument juridik detyrues i nënshkruar nga përfituesi, qoftë duke i bërë operimet vetë apo duke angazhuar dikë tjetër për ata;

1.28. **Provizione teknike** - shumat e përcaktuara në bazë të metodave aktuale, të cilat

mbahen nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jo-jetës;

1.29. **Provizione matematike** - shumat e përcaktuara në bazë të metodave aktuale, të cilat mbahen nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës;

1.30. **Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë** – shpenzimet e krijuara për humbjet e pritura nga kreditë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

1.31. **Transferimi i çmimit** - nënkupton përcaktimin e çmimit të mallrave dhe shërbimeve të shitura në mes të personave të lidhur në mes veti brenda një grupi të ndërmarrjes shumëkombëshe;

1.32. **Transaksion i kontrolluar** - nënkupton çdo transaksion midis personave të lidhur;

1.33. **Ministër** - Ministri i Financave;

1.34. **Konsiderata** - çdo veprim ose akt i heqjes dorë në lidhje me furnizimin e mallrave ose shërbimeve, dhe/apo duhet të përfshijë çdo shumë që është e pagueshme ose mallrat apo shërbimet e pranuar nëpërmes të transaksionit barter.

#### **Neni 4 Tatimpaguesit**

1. Sipas këtij ligji tatimpagues janë personat e mëposhtëm:

1.1. Korporata apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;

1.2. shoqëria tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;

1.3. organizata e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas legjislacionit përkatës që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e Organizatave jo qeveritare (OJQ) në Kosovë;

1.4. personi jo rezident me njësi të përhershme në Kosovë, duke iu nënshtruar paragrafit 2 të nenit 5 të këtij ligji.

#### **Neni 5 Objekti i tatimit**

1. Objekti i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

2. Objekti i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

#### **Neni 6 Të ardhurat e tatueshme**

1. Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme është ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas këtij ligji.

2. Nga paragrafi 1 i këtij neni përjashtohen:

2.1. të ardhurat e tatueshme nga projektet dhe kontratat afatgjate të ndërtimit;

2.2. të ardhurat e tatueshme nga lizingjet operuese dhe lizingjet financiare;

2.3. të ardhurat bruto nga interesi, që përfshijnë:

2.3.1 interesin nga huat e dhëna për personat apo entitetet;

2.3.2. interesin nga flet obligacionet ose letrat tjera me vlerë të lëshuara nga organizatat afariste;

2.3.3. interesin nga llogaritë (e kursimeve) të cilat sjellin interes, e që mbahen në banka dhe në institucione të tjera financiare.

3. Për tatimpaguesin i cili nuk tatóhet në të ardhura reale, të ardhura të tatueshme konsiderohen të ardhurat bruto.

4. Të ardhurat bruto nga interesi sipas nënparagrafit 2.3 të këtij neni nuk përfshijnë interesin nga mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë apo nga cilido fond tjetër pensional i përkufizuar sipas legjislacionit përkatës mbi kursimet pensionale në Kosovë.

5. Mënyra e raportimit të të ardhurave të tatueshme sipas nënparagrafëve 2.1, 2.2 dhe 2.3 të këtij neni rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

#### **Neni 7 Shkallët e tatimit**

Tatimi në të ardhurat e korporatave është dhjetë përqind (10%) e të ardhurave të tatueshme.

### **KAPITULLI II TË ARDHURAT E LIRUARA**

#### **Neni 8 Të ardhurat e liruar**

1. Të ardhurat si në vijim lirohen nga tatimi në të ardhurat e korporatave:

1.1. përveç rasteve të parapara me nenin 34 të këtij ligji, të ardhurat e organizatave të regjistruara sipas legjislacionit për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave si organizata joqeveritare që kanë fituar dhe mbajtur statusin e përfituesit publik, me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik;

1.2. të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të lejuara dhe të autorizuara për të vepruar në Kosovë;

1.3. interesi nga instrumente financiare i lëshuar apo garantuar nga Autoriteti Publik i Kosovës, i paguar për tatimpaguesin rezident apo jo rezident;

1.4. të ardhurat e Bashkësive fetare sipas Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë;

1.5. të ardhurat e kontraktorëve primar ose nën-kontraktorëve, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-it dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore, me kusht që ata drejtpërdrejt të jenë të angazhuar në projekte dhe programe të organizatave të cekura më lartë;

- 1.6. të ardhurat e kontraktorëve primar ose nën-kontraktorëve, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë, Bashkimin Evropian, Agjencitë e Specializuara të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtarë dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në mbështetje të projekteve dhe programeve për Kosovën;
  - 1.7. të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit;
  - 1.8. dividenda e paguar apo pranuar për personin rezident dhe jorezident.
2. Organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.
  3. Pushimet tatimore dhe lehtësirat e tjera të veçanta për bizneset që paraqesin projekte dhe investime të reja, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **KAPITULLI III SHPENZIMET**

#### **Neni 9 Shpenzimet e palejueshme**

1. Gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme, nuk lejohet zbritje për:
  - 1.1. shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës;
  - 1.2. koston e përmirësimit, renovimit dhe rikonstruksionit të mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar, nuk do të njihen shpenzim i periudhës, por do të trajtohen në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;
  - 1.3. gjambat, ndëshkimet dhe interesi që shqiptohen nga ndonjë autoritet publik dhe, shpenzimet që lidhet me ato;
  - 1.4. tatimin në të ardhura i paguar ose i lindur për periudhën tatimore aktuale ose të mëparshme dhe çdo interes ose ndëshkim i krijuar për pagesë me vonesë të tij;
  - 1.5. tatimi mbi vlerën e shtuar, për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim për tatimin e zbritshëm në bazë të legjislacionit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;
  - 1.6. humbjen tatimore nga transaksionet ndërmjet personave të lidhur, me përjashtim të rasteve kur është në përputhje me vlerën e hapur të tregut;
  - 1.7. kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar sipas legjislacionit përkatës për pensionet në Kosovë;
  - 1.8. shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit, të cilat janë pjesë e shpenzimeve të përfaqësimit;
  - 1.9. humbjet në peshë specifike apo substancë, dëmtimet, mbetjet, tepricat, shkatërrimet apo thyerjet gjatë prodhimit, transportit, magazinimit dhe ekspozimit, përtej normave të përcaktuara me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;
  - 1.10. përfitimet në natyrë në formë të shujtës dhe transportit, përveç rasteve kur organizohet nga biznesi;

1.11. shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jorezident, pavarësisht nga kushtet e kontratës së punësimit apo shërbimit;

1.12. shpenzimet e mbuluara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;

1.13. shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion, përveç nëse kanë ndodhur në lidhje me afarizmin e tatimpaguesit që ofron aktivitetet për dëfrim dhe rekreacion.

## **Neni 10** **Shpenzimet e lejueshme**

1. Në varësi të kufizimeve të këtij ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit.

2. Shpenzimet edukativo-arsimore të paguara nga një punëdhënës në një institucion edukativo-arsimor për një të punësuar, janë të lejueshme në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla janë paguar, me kusht që:

2.1. shpenzimet edukativo-arsimore të jenë paguar drejtpërdrejtë në institucionin edukativo-arsimor;

2.2. institucioni edukativo-arsimor është i pranuar me legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë;

2.3. edukim-arsimimi lidhet me pozitën e të punësuarit dhe nuk e kualifikon atë të punësuar për punë në një profesion tjetër; dhe

2.4. i punësuarit mbetet në punësim të punëdhënësi pas përfundimit të edukimit-arsimimit, për të cilin shpenzimet janë paguar nga punëdhënësi për një periudhë kohore të specifikuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

3. Shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar, që lidhen me punën, lejohen në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

4. Nëse një tatimpagues, ndryshe nga një tatimpagues i angazhuar në afarizëm për dhënie me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, zgjedh të mos mbajë regjistrime të shpenzimeve aktuale të paguara apo të lindura në aktivitetin e qirasë, tatimpaguesit të tillë i lejohet një zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë përqind (10%) të qirave të pranuar me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të riparimit, arkëtimit të pagesave dhe të shpenzimeve tjera të paguara apo të krijuara gjatë realizimit të qirasë.

5. Nuk do të lejohet zbritje për çdo shpenzim të rrjedhë bazuar në një obligim të mbajtjes në burim, përveç nëse shpenzimet e tilla të jenë paguar në ose para 31 marsit të periudhës pasuese tatimore. Çdo shpenzim i palejuar nga ky paragraf është i zbritshëm në periudhën tatimore në të cilën në të vërtetë është paguar.

6. Ministri nxjerr akt nënligjor për shpenzimet e dokumentuara të cilat rrjedhin nga vlerësimet dhe rivlerësimet doganore.

7. Shpenzimet, përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit që lidhen me lizingjet operuese dhe lizingjet financiare, raportohen në mënyrën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.



8. Nuk lejohet si zbritje për shpenzimet përveç atyre shpenzimeve të dokumentuara në mënyrën e kërkuar me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

### **Neni 11**

#### **Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik**

1. Kontributet e dhëna, nga tatimpaguesit që mbajnë libra dhe regjistrime sipas paragrafit 5 të nenit 35 të këtij ligji, në formë të donacionit dhe sponsorizimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij ligji konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut:

1.1. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

2. Një kontribut i lejueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t'i bëhet:

2.1. një organizate të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi mbi themelimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare që ka pranuar dhe mbajtur statusin e beneficuar publik;

2.2. çdo organizate tjetër që në mënyrë të drejtpërdrejtë kryen aktivitete me interes publik, siç janë:

2.2.1. institucionet shëndetësore;

2.2.2. institucionet edukativo-arsimore;

2.2.3. organizatat për mbrojtjen e mjedisit;

2.2.4. institucionet fetare;

2.2.5. institucionet që përkujdesen për persona me nevoja të veçanta apo për persona të moshuar;

2.2.6. jetimoret; dhe

2.2.7. institucionet në përkrahje të shkencës, kulturës, sportit apo të arteve.

3. Zbritja e lejueshme nuk përfshinë kontributin nga i cili direkt apo indirekt përfitojnë donatorët ose personat e afërm me donatorin.

4. Secili tatimpagues që kërkon zbritje të lejueshme duhet t'i paraqesë ATK-së dëftesën e pagesës për një zbritje të tillë.

5. Përveç zbritjes së lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesit që do të kontribuojnë në fusha të caktuara, do të kenë një lejim special deri në dhjetë përqind (10%) nëse parashihen me ligje të veçanta në Kosovë.

6. Për zbatimin e këtij neni Ministri nxjerr akt nënligjor.

### **Neni 12**

#### **Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promovimit ekonomik**

1. Në shpenzimet e përfaqësimit përfshihen shpenzimet me karakter të përgjithshëm që një person afarist bënë për prezantimin e tij në marrëdhënie me partnerët apo institucionet e tjera,

si: organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, përrurimi i linjave apo prodhimeve të reja, qerasjet dhe pritje-përcjelljet që lidhen me aktivitetin e biznesit.

2. Shpenzimet e përfaqësimit janë të kufizuara në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.

3. Shpenzimet e reklamës dhe promocionit të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billbordat, reklamat tranzite e të tjera të ngjashme, janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.

### **Neni 13** **Shpenzimet e Borxhit të keq**

1. Një borxh i keq konsiderohet shpenzim nëse i plotëson kushtet vijuese:

1.1 pagesa nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht dhe është shpallur si i pamblledhshëm duke iniciuar procedurat në organet gjyqësore;

1.2. borxhit i kanë kaluar së paku gjashtë (6) muaj nga afati i obligimit për pagesë;

1.3. shuma që korrespondon me borxhin më herët është përfshirë në evidenca kontabël si e ardhur;

1.4. nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;

1.5. ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë:

1.5.1. tatimpaguesi ka balancuar çdo borxh të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq;

1.5.2. korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për të vjelë borxhin;

1.5.3. kërkesa është dorëzuar mbi mjetet e falimentimit/likuidimit, nëse është e aplikueshme dhe shuma që merret është përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga administratori, përmbaruesi, si dhe deri në shkallën sa janë marrë nga falimentimi, janë aplikuar në borxhin e pashlyer.

1.6. tatimpaguesi lëshon një faturë për shumën e paarkëtuar ku shkruhen fjalët "Borxh i keq", si dhe numri i faturës, me të cilën lidhet ky borxh, faturë, e cila i shërben shitësit për të zvogëluar të ardhurën dhe blerësit për të zvogëluar shpenzimin (koston);

1.7 Për shumën deri në pesëqind (500) Euro euro të trajtuar si borxh të keq nuk kërkohet inicimi i procedurave në organet gjyqësore.

2. Zbritjet e borxhit të keq janë të kufizuara në pjesën e pambuluar të borxhit. Çdo borxh i keq i zbritur si një shpenzim dhe pastaj është mbledhur, përfshihet në të ardhurat e tatimpaguesit në kohën e mbledhjes.

3. Shuma e paarkëtuar nuk konsiderohet borxh i keq nëse:

3.1. transaksionet me të njëjtin borxhli janë përsëritur pas shpalljes së borxhit të keq, me përjashtim të shërbimeve publike;

3.2. borxhi i keq është ndërmjet palëve të lidhura;

3.3. nuk ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të mbledhur borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit;

3.4. procedurat për ta shpallur borxh të keq nuk janë iniciuar brenda njëzet e katër (24) muajve nga data e obligimit për pagesë.

4. Ministri nxjerr akt nënligjor për të përshkruar kërkesat për zbritjen e borxhit të keq sikur që është paraparë me këtë nen.

#### **Neni 14**

##### **Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë dhe provizionet teknike dhe matematike**

1. Provizionet për humbjet e pritura nuk lejohen si shpenzime të zbritshme në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, përveç rasteve të parapara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të licencuara nga BQK, për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që të njohin shpenzime të zbritshme provizionet për humbjet e pritura nga kreditë deri në tetëdhjetë (80%) përqind të shumës së përcaktuar me akt nënligjor të nxjerr nga BQK.

3. Institucionet Financiare të Sigurimeve dhe Risigurimeve, të licencuara nga BQK, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që t'iu njihen shpenzimet e zbritshme, provizionet për rezervat teknike dhe matematike, deri në tetëdhjetë përqind (80%) të shumës së përcaktuar me Ligjin për Sigurimet dhe aktet nënligjore të nxjerra nga BQK.

4. Pas njohjes së provizioneve sipas paragrafit 2 të këtij neni, çdo shumë e zvogëluar nga mbledhja e kredive të provizionuara, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumat e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.

5. Pas njohjes së provizioneve teknike dhe matematike sipas paragrafit 3 të këtij neni, çdo shumë e zvogëluar nga provizionet, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumat e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.

6. Në rast se BQK kërkon korrigjim të provizioneve të deklaruara sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, ndryshimet e tilla duhet të rregullohen në deklaratë tatimore.

7. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.

#### **Neni 15**

##### **Pagesat për personat e lidhur**

1. Kompensimi ose pagat e paguara për personin e lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.

2. Interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.

#### **Neni 16**

##### **Zhvlerësimi**

1. Shpenzimet për pronën e prekshme, përveç shpenzimeve për tokën, veprat artistike dhe pronën tjetër e cila nuk konsumohet që i posedon tatimpaguesi dhe që shfrytëzohen për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit, kompensohen me kalimin e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.

2. Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të

tatimpaguesit, kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.

3. E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas këtij neni, klasifikohet në njëërën prej kategorive vijuese:

3.1. Kategoria 1 - ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;

3.2. Kategoria 2 - automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobilet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë, dhe bagëtitë e shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim;

3.3. Kategoria 3 - uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet, bimët shumë vjeçare dhe bimët e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave; dhe të gjitha asetet e prekshme që nuk janë përfshirë në kategorinë 1 apo kategorinë 2 të këtij paragrafi.

4. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale, sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore sipas kategorisë së cilës i përkasin asetet:

4.1. Kategoria 1- pesë përqind (5%);

4.2. Kategoria 2- njëzet përqind (20%); dhe

4.3. Kategoria 3- dhjetë përqind (10%).

5. Një pasuri për aspekte zhvlerësimi merret parasysh kur vihet për herë të parë në përdorim.

6. Shuma fillestare që zhvlerësohet është çmimi i blerjes apo, në mungesë të çmimit të blerjes, çmimi i kostos. Shuma fillestare përfshinë:

6.1. detyrimet tatimore, ngarkesat, taksat dhe kamatat që i ngarkohen kësaj pasurie para se të vihet në shërbim pasuria;

6.2. shpenzimet e rastit sikurse janë provizioni, paketimi, transporti dhe shpenzimet e sigurimit të ngarkuara nga furnizuesi.

7. Blerja e një pasurie për çmimin deri në njëmijë (1,000) Euro lejohet si shpenzim rrjedhës, me përjashtim kur pasuria funksionon si pjesë e një tërësie dhe vlera e tërësisë kalon mbi njëmijë (1,000) Euro dhe afati i jetëgjatësisë është mbi një (1) vit.

#### **Neni 17**

#### **Zhvlerësimi i aktiveve biologjike**

1. Zhvlerësimi i aktiveve biologjike është i lejuar vetëm nëse janë përdorë gjatë rrjedhës së aktiviteteve ekonomike të entitetit bujqësor.

2. Zhvlerësimi i aktiveve biologjike sipas paragrafit 1 të këtij neni, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 18**

#### **Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja**

1. Nëse një tatimpagues blen linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventar të hekurudhës dhe lokomotiva që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anije, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e aktiviteteve ekonomike të tatimpaguesit, përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm, lejohet një zbritje e veçantë prej dhjetë për qind të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim.
2. Zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë apo jashtë Kosovës.
3. Zbritjet tjera të posaçme mund të jepen vetëm nëse parashihen me ligj të veçantë.
4. Zbritja sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk lejohet për personat të cilët përfitojnë sipas nenit 8, paragrafit 3 të këtij ligji.

### **Neni 19**

#### **Riparimet dhe përmirësimet**

1. Në rast të ndonjë aseti të zhvlerësueshëm, shumat e shpenzuara për riparime apo për përmirësime, përjashtuar riparimet e mirëmbajtjes së zakonshme, kapitalizohen dhe shtohen në bazën e asetit nëse riparimet apo përmirësimet tejkalojnë jetën e përdorimit të asetit për së paku një (1) vit dhe shuma e riparimit apo përmirësimit është më e madhe se njëmijë (1,000) Euro për atë aset. Nëse riparimi apo përmirësimi është njëmijë (1,000) Euro apo më pak për ndonjë aset, shuma e riparimit apo përmirësimit është shpenzim në vitin që është paguar apo ka ndodhur.
2. Nëse riparimet apo përmirësimet plotësojnë kriterin për kapitalizim sipas paragrafit 1 të këtij neni, shuma kapitalizohet dhe shtohet në vlerën kontabël të mbetur të asetit kapital. Vlera e re kontabël e asetit përdoret si bazë për zhvlerësimin e asetit. Aseti zhvlerësohet në përputhje me rregullat e kategorisë së aplikueshme.
3. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.

### **Neni 20**

#### **Amortizimi**

1. Shpenzimet për mjetet e paprekshme, të cilat kanë afat të kufizuar përdorimi, përfshirë patentet, të drejtat e autorit, licencat për vizatime apo modele, kontratat dhe të drejtat ekskluzive, zbriten në formë të detyrimeve të amortizimit.
2. Metoda e amortizimit është metoda e shlyerjes lineare dhe lejimi bazohet në afatin e përdorimit të pasurisë të përcaktuar në marrëveshjen ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme.
3. Në rastet kur afati i përdorimit nuk është i përcaktuar, shpenzimet e amortizimit lejohen deri në njëzet (20) vite.

### **Neni 21**

#### **Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore**

1. Shpenzimet për kërkim dhe zhvillim lidhur me rezervat natyrore të mineraleve dhe të resurseve të tjera natyrore, si dhe kamatat që u ngarkohen, i shtohen llogarisë kapitale dhe

amortizohen sipas këtij neni.

2. Shuma e lejuar si zbritje për amortizim përkitazi me shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore, e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, për periudhën tatimore, përcaktohet duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me një thyesë:

2.1. numëruesi i së cilës paraqet njësitë e nxjerra prej rezervave natyrore gjatë vitit, dhe

2.2. emëruesi i së cilës paraqet shumën e njësive të përgjithshme të parapara për t'u nxjerrë nga rezervat natyrore gjatë jetëgjatësisë së pasurisë.

3. Njësitë e përgjithshme të parapara për nxjerrje, të referuara në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohen në përputhje me udhëzimet lidhur me vlerësimet e tilla që përshkruhen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

## **KAPITULLI IV FITIMET DHE HUMBJET NË KAPITAL, HUMBJET NË BIZNES**

### **Neni 22 Fitimet dhe humbjet në kapital**

1. Fitimet kapitale nënkuptojnë të ardhurën, të cilën tatimpaguesi e realizon përmes shitjes apo formave tjera të tjetërsimit të pasurive kapitale duke përfshirë pasurinë e tundshme, patundshme dhe letrat me vlerë.

2. Shuma e fitimit kapital paraqet dallimin pozitiv të çmimit të shitjes së pasurisë kapitale dhe të çmimit të pasurisë siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

3. Çmimi i shitjes së një pasurie kapitale është shuma e çdo paraje të pranuar, plus çdo kompensim tjetër i pranuar, si konsideratë për atë shitje.

4. Nëse palët janë persona të lidhur dhe çmimi i shitjes është më i vogël se vlera e hapur e tregut, atëherë, për qëllim të këtij neni, çmimi i shitjes do të rregullohet në vlerën e hapur të tregut në mënyrën e përshkruar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

5. Kostoja e pasurisë kapitale është shuma, të cilën tatimpaguesi e ka paguar për përvetësimin e pasurisë, e rritur për koston e përmirësimeve dhe e zvogëluar nga zhvlerësimi dhe shpenzimet tjera që lejohen me këtë ligj.

6. Fitimet kapitale pranohen si të ardhura biznesi dhe humbjet kapitale si humbje biznesi, nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

7. Humbja kapitale nënkupton humbjen që e pëson tatimpaguesi nga shitja apo ndonjë formë tjetër e tjetërsimit të pasurisë kapitale, përfshirë pasurinë e tundshme, patundshme dhe letrat me vlerë.

8. Shuma e humbjes në kapital paraqet dallimin negativ në mes të çmimit të shitjes së pasurisë kapitale sipas paragrafit 3 apo 4 të këtij neni dhe koston së pasurisë kapitale siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

9. Humbjet kapitale trajtohen sikurse humbje të zakonshme nga veprimtaritë ekonomike. Dispozitat e nenit 24 të këtij ligji aplikohen për humbjet e përshkruara në këtë paragraf.

10. Të ardhurat bruto nga fitimet kapitale nuk përfshijnë fitimet kapitale të realizuara nga shitja e pasurisë së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës apo ndonjë fondi tjetër pensional të

përkufizuar me legjislacionin mbi pensionet në Kosovë.

11. Një fitim kapital nuk pranohet në shndërrimin e pavullnetshëm të pasurisë deri në shkallën sa konsiderata e pranuar nga shndërrimi që përbëhet qoftë nga pasuria e të njëjtit karakter ose natyre, apo nga para që janë investuar në pasuri të të njëjtit karakter apo natyre përbrenda një periudhe zëvendësuese prej dy (2) vjetëve.

12. Nëse një shitje e një asemi kapital përfshinë një marrëveshje me këste që zgjatë më shumë se periudha tatimore në të cilën shitja është finalizuar, ku të gjitha dokumentet e aplikueshme janë nënshkruar nga të gjitha palët dhe marrëveshja e shitjes është ligjërisht e zbatueshme, çdo fitim duhet të raportohet në bazë lineare gjatë ekzistencës së marrëveshjes me këste dhe shumës së fitimit që i atribuohet çdo periudhe tatimore duhet të raportohet në deklaratën tatimore si e ardhur në atë periudhë tatimore. Dispozitat tjera që lidhen me shitjet me këste rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

### **Neni 23 Shndërrimi jo i vullnetshëm**

1. Fitimi kapital nuk pranohet në rast të ndërrimit pa dashje të pronës nëse konsiderata është marrë nga ndërrimi që përbëhet nga prona e karakterit apo natyrës së njëjtë ose nga paratë që janë investuar në pronën e natyrës apo të karakterit të njëjtë brenda periudhës dy (2) vjeçare të zëvendësimit.

2. Fitimi kapital sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 24 Humbjet Tatimore**

1. Humbja tatimore është ndryshimi negativ ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të lejuara të përcaktuara me këtë ligj.

2. Shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, bartet deri në katër (4) periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

3. Shuma e bartur që merret parasysh për çfarëdo periudhe tatimore pas vitit të humbjes tatimore, është shuma e përgjithshme e humbjes e zvogëluar për shumën e grumbulluar që është lejuar më parë si zbritje.

4. Nëse tatimpaguesi ka pasur humbje tatimore më gjatë se një (1) vit, ky nen zbatohet për humbjet që janë krijuar sipas radhës.

5. Përveç sikurse është paraparë në nenin 27 të këtij ligji, dispozitat e këtij neni janë të lejueshme vetëm për biznesin i cili ka krijuar humbje. Nëse biznesi ndryshon llojin e organizatës biznesore apo ka ndryshim të pronësisë për më shumë se pesëdhjetë përqind (50%), bartja nuk do të jetë më e zbatueshme.

6. Ministri nxjerrë akt nënligjor për të rregulluar dispozitat e bartjes së humbjes që lidhen me ndryshimin e llojit të organizatës biznesore apo ndryshimit të pronësisë, si dhe çdo dispozitë tjetër të bartjes së humbjes të nevojshëm për zbatimin e këtij neni.

## **KAPITULLI V LIKUIDIMET DHE RIORGANIZIMET**

### **Neni 25 Shpërndarja e pronës**

1. Kompania që shpërndan pronën, përveç aksioneve të një aksionari, duke pasur parasysh interesin e aksionarit, njih fitimin ose humbjen sikur ajo pronë t'i ishte shitur aksionarit në vlerën e hapur të tregut.
2. Vlera e pronës së shpërndarë për aksionarin vlerësohet sipas vlerës së hapur të tregut të asaj prone.
3. Në rast të shpërndarjes së dividendëve të aksioneve që nuk ndërrojnë hisen e pjesëmarrjes së fituesit, kompania nuk e njih fitimin as humbjen dhe kështu aksionari nuk realizon të ardhura.

### **Neni 26 Likuidimi**

1. Në rast të likuidimit të një kompanie në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi në Kosovë, kompania merr parasysh humbjen apo fitimin sikur ta kishte shitur pronën që është shpërndarë gjatë likuidimit sipas vlerës së hapur të tregut.
2. Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë ligj, pranuesit e pronës së shpërndarë gjatë likuidimit trajtohen sikur ta kishin këmbyer interesin e vlerës së mbetur në kompaninë e likuiduar për shumën që është e barabartë me vlerën e hapur të tregut të asaj prone.
3. Në rast të likuidimit të një filiali ku prona e filialit i shpërndahet një filiali amë, filiali amë nuk pranon kurrfarë humbjesh apo fitimesh.

### **Neni 27 Riorganizimi**

1. Transferimi i pronës në pajtim me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit qoftë për shkak të bankrotimit, bashkimit, përvetësimit, ndarjes, këmbimit të aksioneve, apo të ndonjë arsyeje tjetër, që e miraton ATK, nuk i nënshtrohet tatimeve sipas këtij ligji.
2. Në rast të riorganizimit, vlera e pronës sipas librave të mbajtura nga tatimpaguesi i riorganizuar, përcaktohet në bazë të vlerës së përvetësimit të asaj prone me rastin e riorganizimit.
3. Gjatë riorganizimit, shpërndarja e drejtë e vlerës së interesit të mbetur për aksionarin, nuk paraqet të ardhur të tatueshme për aksionarin.
4. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ndonjë akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri, tatimpaguesi përvetësues trashëgon dhe zëvendëson tatimpaguesin dorëzues përkitazi me inventarin, shumën e humbjes së bartur, konton e dividendës dhe të gjitha zërat tjerë. Bartjet e humbjeve janë të lejueshme te tatimpaguesi përvetësues vetëm nëse janë të parashikuara me planin e riorganizimit dhe të aprovuara nga ATK, në përputhje me rregullat e parapara me aktin nënligjor sipas këtij paragrafi të këtij neni.



## KAPITULLI VI TRANSFERIMI I ÇMIMEVE, SHMANGIA E TATIMIT TË DYFISHTË

### Neni 28 Transferimi i çmimeve

1. Tatimpaguesi që është subjekt i tatimit në të ardhurat e korporatave dhe i cili merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara, përcakton fitimin e tatueshëm në përputhje me vlerën e hapur të tregut për transferim të çmimit.

2. Vlera e hapur e tregut për qëllim të transferimit të çmimit-parimi i tregut - nënkupton parimin kur kushtet janë krijuar apo vendosur në mes të dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare, të cilat dallojnë nga ato të cilat do të krijoheshin në mes të ndërmarrjeve të pavarura, ku çdo fitim nën ato kushte, që do të lindte në njërin nga ndërmarrjet, për shkak të atyre kushteve, nuk kanë lindur, mund të përfshihen në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe në përputhje me to të tatimohen.

3. Për përcaktimin e transferimit të çmimit shfrytëzohen:

3.1. metodat tradicionale të transaksionit, si në vijim:

3.1.1. metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar;

3.1.2. metoda e çmimit të rishitjes; dhe

3.1.3. metoda kosto plus.

3.2. tatimpaguesi mundet në rrethana të caktuara të zbatojë metodat tradicionale të fitimit, si në vijim:

3.2.1. metoda e marzhit neto të transaksionit, dhe

3.2.2. metoda e ndarjes së fitimit.

4. Për qëllime të këtij neni, vlera e hapur e tregut përcaktohet sipas metodës më të përshtatshme krahasuese, e cila përzgjidhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

4.1 përparësitë dhe dobësitë përkatëse të metodave të njohura të transferimit të çmimit;

4.2 përshtatshmërinë e një metode të njohur të transferimit të çmimit në funksion të natyrës së transaksionit të kontrolluar, e cila përcaktohet veçanërisht përmes një analize të funksioneve të kryera nga çdo tatimpagues në transaksionin e rregulluar, duke marrë në konsideratë asetet e përdorura dhe risqet e marra përsipër;

4.3 disponueshmërinë e informacionit të besueshëm të nevojshëm për zbatimin e metodës së zgjedhur të transferimit të çmimit dhe/ose metodave të tjera; dhe

4.4 shkallën e krahasueshmërisë midis transaksioneve të kontrolluara dhe të pakontrolluara, duke përfshirë besueshmërinë e rregullimeve të krahasueshmërisë, nëse ka, që mund të kërkohen për të eliminuar diferencat midis tyre.

5. Të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë transaksione të kontrolluara janë të obliguar që të përgatisin dokumentacionin për transferimin e çmimit. Dokumentacioni për transferimin e çmimit dorëzohet vetëm me kërkesë të ATK-së.

6. Rregullimet përkatëse - kur në kushtet e transaksioneve të kontrolluara bëhet një rregullim

nga organi tatimor i një vendi tjetër dhe ky rregullim rezulton në tatuarjen e fitimeve në atë vend, për të cilat tatimpaguesi është tatuar tashmë në Kosovë, dhe vendi që propozon rregullimin ka një marrëveshje me Kosovën për eliminimin e tatimit të dyfishtë, atëherë në këto kushte ATK, pas dorëzimit të një kërkesë nga tatimpaguesi kosovar, kontrollon përputhshmërinë e atij rregullimi me vlerën e hapur të tregut.

7. Ministri nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.

### **Neni 29** **Shmangia e tatimeve të dyfishta**

1. Tatimpaguesi rezident në Kosovë që përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës dhe i cili paguan tatimin në të ardhura në shtete tjera, sipas këtij ligji i lejohet një kredi tatimore për tatimin në të ardhura të paguar në shtetin tjetër që i atribuohet të ardhurave që krijohen në shtetin tjetër.

2. Krediti tatimor i lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejohet si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e rezidentit të Kosovës, në një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara jashtë Kosovës. Megjithatë, kjo zbritje nuk do të kalojë pjesën e tatimit të Kosovës, të llogaritur para zbritjes së dhënë, që i atribuohet të ardhurave të tatuara jashtë Kosovës.

3. Çdo marrëveshje e zbatueshme ndërkombëtare për eliminimin e tatimit të dyfishtë në të ardhura, ka epërsi në raport me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 30** **Njësia e Përhershme**

1. Për qëllime të këtij ligji, termi “njësi e përhershme” do të thotë një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje në Kosovë për më shumë se gjashtë (6) muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetë (12) mujore.

2. Termi “njësia e përhershme” në veçanti përfshin:

2.1. një vend menaxhimi;

2.2. një degë;

2.3. një zyrë;

2.4. një fabrikë;

2.5. një punëtori;

2.6. një minierë; dhe

2.7. një burim të naftës dhe gazit, gurore ose vend tjetër të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

3. Njësia e përhershme, gjithashtu përfshinë:

3.1 një vend ndërtimi, ndërtimin, montimin ose projekt instalimin, ose aktivitetet mbikëqyrëse në lidhje me këtë, por vetëm nëse ndërtimi, projekti ose aktiviteti i tillë zgjat më shumë se njëqind e tetëdhjetë e tri (183) ditë brenda çdo periudhe dymbëdhjetë (12) mujore. Në përlllogaritjen e periudhës njëqind e tetëdhjetë e tri (183) ditë, llogaritet dita kur ka filluar puna e tillë (realisht, aktualisht), duke përfshirë edhe aktivitetet përgatitore;

3.2. ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë shërbime konsultuese, të kryera në Kosovë nga personi jo rezident përmes punëtorëve ose personelit tjetër, nëse aktivitetet e tilla vazhdojnë për një periudhë gjithsej më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe dymbëdhjetë (12) mujore të njëpasnjëshme. Në përlogaritjen e periudhës nëntëdhjetë (90) ditë, llogaritet dita kur (realisht, aktualisht) kanë filluar aktivitetet e tilla, ofrimin e shërbimeve në Kosovë nga një individ, por vetëm nëse ai individ qëndron në Kosovë për një periudhë gjithsej më shumë se njëqind e tetëdhjetë e tri (183) ditë brenda çdo periudhe dymbëdhjetë (12) mujore;

3.3 çdo pasuri e paluajtshme që ndodhet në Kosovë dhe posedohet nga një person jo rezident.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “njësi e përhershme” nuk përfshinë:

4.1. përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

4.2. mbajtjen e një stoku mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

4.3. mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

4.4. mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacioneve për ndërmarrjen;

4.5 mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllime të reklamimit, për ofrimin e informatave, për kërkime shkencore apo aktivitete të ngjashme që kanë një karakter përgatitor ose ndihmës për ndërmarrjen;

4.6 një projekt instalimi ose grumbullimi e ushtruar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues në lidhje me shpërndarjen e makinerive apo pajisjeve të prodhuara nga kjo ndërmarrje;

4.7 mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nën paragrafët 4.1 deri 4.6 të këtij neni, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Paragrafi 4 i këtij neni nuk aplikohet për një vend fiks të biznesit, në Kosovë, i cili është shfrytëzuar ose mirëmbajtur nga një person jo rezident nëse i njëjti person ose personat të lidhur me të zhvillojnë aktivitet biznesor në të njëjtin vend ose në një vend tjetër në Kosovë, dhe:

5.1 ai vend ose vendi tjetër krijon njësi të përhershme për personin jo rezident ose të personave të lidhur me të, sipas dispozitave të këtij neni, ose

5.2 aktiviteti i përgjithshëm rezulton nga kombinimi i aktiviteteve të zhvilluara nga dy personat e lidhur në të njëjtin vend në Kosovë, ose nga personi jo rezident ose personave të lidhur në dy vende në Kosovë, e që nuk janë të karakterit të aktiviteteve përgatitore ose ndihmëse, e që sigurojnë që aktivitetet biznesore të zhvilluara nga dy personat jo rezident në vendin e njëjtë në Kosovë, ose nga i njëjti person jo rezident ose personave të lidhur në dy vende në Kosovë, përbëjnë funksione plotësuese që janë pjesë e veprimtarisë biznesore koherente.

6. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 7 të këtij neni, vepron në Kosovë

në emër të një personi jo rezident dhe rregullisht ushtron autoritet për të lidhur kontrata në emër të atij personi jo rezident, personi jo rezident konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në Kosovë në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për personin jo rezident, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4 të këtij neni, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi njësi të përhershme sipas dispozitave të paragrafit 4 të këtij neni.

7. Personi jo rezident nuk konsiderohet të ketë njësi të përhershme në Kosovë vetëm pse zhvillon biznesin në Kosovë nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisionar të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë në rrjedhën e zakonshme të biznesit të tyre.

8. Fakti që personi jo rezident, kontrollon ose kontrollohet nga një kompani, e cila është rezidente e Kosovës ose që zhvillon biznes në Kosovë (qoftë nëpërmjet një njësie të përhershme ose ndryshe), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar një kompani njësi të përhershme të kompanisë tjetër.

## KAPITULLI VII MBAJTJA NË BURIM E TATIMEVE

### Neni 31

#### **Tatimi i mbajtur në burim në paga, pensione, interesi, të drejtat pronësore, qiratë, fitoret në lotari dhe lojërat e fatit**

1. Secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara punëtorëve të tij, duke përfshirë pagesat për personat fizik jo afarist, për shërbimet profesionale, teknike, të menaxhimit, financiare, pagesat për kontratat mbi vepër, pagesat për shfaqje të aktorëve, muzikantëve, sportistëve, agjentëve të varur, gjatë çdo periudhe të listë pagesës për të cilën të ardhurat e tyre janë paguar:

1.1. punëdhënësi kryesor i një të punësuarit, mbanë një shumë për periudhën e duhur sipas listë pagesave, në përputhje me shkallët e parapara në legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale;

1.2. punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të barabartë me dhjetë përqind (10%) të pagave të tatueshme për secilën periudhë tatimore;

1.3. pensionet e paguara nga apo për interes të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve i rregulluar me legjislacionin mbi kontributet pensionale, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve, të tilla në shkallët e parapara në legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale;

1.4. secili punëdhënës që kërkohet të mbajë në burim sipas këtij neni, dorëzon pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në llogari të caktuar nga ATK, në një bankë, apo institucion financiar, të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (tash e tutje BQK) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

2. Tatimpaguesit që paguajnë interes nga kreditë e marra duke përfshirë huazimet me përjashtim siç është paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, apo të drejta pronësore personave rezidentë dhe jo rezidentë, mbajnë në burim tatimin në shkallën dhjetë përqind (10%) në kohën e pagesës apo kreditimit dhe transferojnë tatimin e mbajtur në burim në një llogari të përcaktuar nga ATK,

në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga BQK. Tatimi i mbajtur në burim paguhet në bankë, apo institucion financiar deri në ditën e pesëmbëdhjetë (15) të muajit që pason muajin në të cilin llogaria është kredituar apo pagesa është bërë.

3. Çdo tatimpagues që paguan qira mban tatimin në burim nëntë përqind (9%) në kohën e pagesës apo të kreditimit dhe transferon tatimin e mbajtur në një llogari të caktuar nga ATK, në bankë ose institucion financiar të licencuar nga BQK. Tatimi i mbajtur në burim duhet të paguhet në bankë apo institucion financiar deri në ditën e pesëmbëdhjetë (15) të muajit që pason muajin në të cilin pagesa është bërë apo është kredituar, me përjashtim në rastet kur të ardhurat e qiradhënësit janë të liruara nga tatimi.

4. Interesi në kreditë e dhëna nga institucionet financiare të licencuara nga BQK për klientët e tyre në kursin normal të biznesit të tyre dhe interesi në instrumentet financiare të lëshuara ose të garantuara nga Autoriteti Publik i Kosovës, nuk duhet t'i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim.

5. Secili tatimpagues që kërkohet të mbajë tatimin në burim sipas këtij neni, para datës 1 mars të vitit vijues që pason periudhën tatimore, i siguron pranuesit të të ardhurave, një certifikatë të tatimit të mbajtur në burim në formën e specifikuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

6. Tatimi i mbajtur në burim për kategoritë tjera që nuk janë të përfshira në këtë nen, trajtohen në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale.

7. Çdo tatimpagues i cili i paguan personit rezident dhe jorezident, për fitoren në lotari apo lojëra të fatit, është i obliguar të mbajë tatimin në burim prej dhjetë (10) për qind, në kohën e pagesës apo kreditimit.

### **Neni 32**

#### **Mbajtja e Tatimit në Burim për Kategori të Veçanta**

1. Çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej një përqind (1%) në bruto pagesë, në momentin e pagesës.

2. Secili tatimpagues, që kërkohet të mbajë tatimin në burim sipas paragrafit 1 të këtij neni, dorëzon pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK, në një bankë, apo institucion financiar, të licencuar nga BQK brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

3. Secili tatimpagues që kërkohet të mbajë tatimin në burim sipas paragrafit 1 të këtij neni, para datës 1 mars të vitit vijues të periudhës tatimore, i siguron secilit person fizik jo afarist nga i cili është mbajtur tatimi në burim, një certifikatë të tatimit të mbajtur në burim në formën e specifikuar me aktin nën ligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 33**

#### **Mbajtja në burim në pagesa të caktuara për jo-rezidentët**

1. Të ardhurat që i atribuohen një jo-rezidenti në Kosovë si një zbavitës, sikurse është teatri, figurat e lëvizshme, artistë radioje apo televizioni, ose një këngëtar apo muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet e tija apo saja të ushtruara në Kosovë, i nënshtrohet mbajtjes në burim nga paguesi i atyre të ardhurave, qoftë të paguara drejtpërdrejtë apo tërthorazi jo rezidentit.

2. Të ardhurat, përveç të ardhurave të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, të realizuara nga marrëveshjet apo kontratat, qofshin me shkrim apo me gojë, me personat apo entitetet e

Kosovës nga një person apo entitet jo-rezident nga shërbimet e kryera në Kosovë, i nënshtrohen mbajtjes në burim nga paguesi i atyre të ardhurave, përderisa personi apo entiteti jo-rezident nuk ka njësi të përhershme në Kosovë.

3. Pavarësisht nga dispozitat tjera në këtë ligj, shumta e mbajtjes në burim sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, është pesë (5%) e kompensimit bruto. Secili pagues dorëzon një pasqyrë të mbajtjes në burim dhe transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në një llogari të caktuar nga ATK, në një bankë apo institucion financiar të licencuar nga BQK brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

4. Mbajtja në burim sipas këtij neni konsiderohet të jetë tatim përfundimtar dhe pranuesit e të ardhurave të tilla që i nënshtrohen mbajtjes në burim nuk dorëzojnë deklaratë në ATK, pavarësisht dispozitave të nenit 37 të këtij ligji.

5. Secili pagues i cili mban në burim sipas këtij neni gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, para datës 1 mars të vitit vijues që pason periudhën tatimore, i siguron pranuesit të të ardhurave një certifikatë të tatimit të mbajtur në burim në formën e specifikuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

6. Çdo tatimpagues i cili mban në burim tatimin sipas këtij neni gjatë një periudhe tatimore dorëzon në ATK një pasqyrë barazimi vjetore në formë dhe format të specifikuar nga ATK para datës 1 mars të vitit që pason periudhën tatimore. Çdo tatimpagues duhet të përfshijë një kopje të të gjitha certifikatave të mbajtjes në burim, që kërkohen me paragrafin 5 të këtij neni, me pasqyrën vjetore të barazimit të dorëzuar në ATK.

7. Ministri nxjerr akt nënligjor që përcakton personat apo entitetet të jenë pagues sipas këtij neni dhe të gjitha aktivitetet tjera të kërkuara për zbatimin e këtij neni.

## **KAPITULLI VIII DISPOZITAT E VEÇANTA**

### **Neni 34**

#### **Trajtimi i të ardhurave komerciale të organizatave joqeveritare**

1. Organizatës joqeveritare, e cila ndërmerr aktivitete komerciale ose aktivitete të tjera që nuk janë të lidhura me qëllimin e saj publik, i caktohet tatimi në të ardhura në shkallë prej dhjetë përqind (10%) për të ardhurën nga një aktivitet i tillë biznesi, të zvogëluar nga cilado zbritje, e cila është drejtpërdrejt e lidhur me kryerjen e biznesit të tillë dhe e cila është e lejuar me këtë ligj.

2. ATK ka autoritet të kontrolloj çdo OJQ për të përcaktuar respektimin e rregullave me të cilat punojnë OJQ-të. Në rastet kur konstatohet që fitimet e OJQ-së e tejkalojnë nivelin e arsyeshëm të fitimeve të një organizate që është krijuar si organizate jofitimprurëse, ATK ka autoritet të trajtoj fitimet e tepërta në pajtueshmëri me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Çdo OJQ që angazhohet në aktivitetet e liruara nga tatimi sipas nën-paragrafit 1.1 të nenit 8, të këtij ligji dhe në aktivitetet tjera komerciale, duhet të mbajë shënimet dhe regjistrimet e veçanta për aktivitetin e përfitimit publik dhe për aktivitetet tjera komerciale.

4. Ministri nxjerr akt nënligjor me të cilin parasheh kuptimin e termit "fitim i tepruar" sipas këtij neni.

## KAPITULLI IX DISPOZITAT ADMINISTRATIVE

### Neni 35 Kërkesa për Libra dhe Regjistrime

1. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto, nga veprimtaritë afariste për periudhë tatimore mbi tridhjetë mijë (30,000.00) Euro, mban libra dhe regjistrime të identifikuar në paragrafin 5 të këtij neni.

2. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto, nga aktivitetet afariste për periudhë tatimore, deri në tridhjetë mijë (30,000.00) Euro mund të zgjedh të përgatis librat dhe regjistrimet të identifikuar në paragrafin 5 të këtij neni.

3. Tatimpaguesi, sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe ai i cili zgjedh të përgatisë librat dhe regjistrimet e identifikuar në paragrafin 5 të këtij neni, kërkohet të përgatisë librat dhe regjistrimet e tilla për periudhën tatimore në të cilën zgjedhja është bërë dhe për së paku tri (3) periudha tatimore pasuese:

3.1. tatimpaguesi që dëshiron të zgjedhë opsionin e përshkruar në paragrafin 5 të këtij neni dorëzon një formular për aplikim në ATK para datës 1 mars të periudhës tatimore në të cilin tatimpaguesi dëshiron të bëjë zgjedhjen dhe se zgjedhja është bërë;

3.2. për tatimpaguesin e ri, deklarata e parë tremujore e dorëzuar do të jetë informatë për ATK-në se zgjedhja sipas paragrafit 5 të këtij neni është bërë.

4. Tatimpaguesi sipas paragrafit 1 të këtij neni, si dhe tatimpaguesi i cili ka zgjedhë të mbajë libra dhe regjistrime sipas paragrafit 5 të këtij neni, mund të kthehet të mbajë librat dhe regjistrimet sipas nenit 36 të këtij ligji, vetëm atëherë kur të ketë kaluar periudha prej tre (3) vite pas periudhës në të cilën zgjedhja është bërë me kusht që në periudhën e fundit të ardhurat e tij janë nën limitin prej tridhjetë mijë euro (30,000.00) Euro:

4.1 tatimpaguesi i cili me të drejtë kërkon për të kthyer opsionin sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet të dorëzojë një kërkesë për miratim në ATK në përputhje me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe të marrë miratimin nga ATK para mbajtjes së librave dhe regjistrimeve në përputhje me nenin 36 të këtij ligji. Miratimi duhet të merret para datës 1 mars të vitit për të cilin tatimpaguesi kërkon miratim.

5. Librat dhe regjistrimet të kërkuara sipas këtij neni, të mbajtura në përputhje me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, janë si në vijim:

5.1. një libër të shitjes në të cilin regjistrohen të gjitha shitjet dhe kthimet;

5.2. një libër të blerjes në të cilin regjistrohen të gjitha blerjet dhe kthimet;

5.3. një ditar arke që regjistron të gjitha hyrjet dhe daljet në para të gatshme;

5.4. një llogari kapitale, nëse është e aplikueshme, që përmban bilancin e hapjes, shtimet në kapital, shpenzimet që do të kapitalizohen, shkalla e zhvlerësimit, shuma e zhvlerësimit, të gatshmet dhe bilanci mbyllës; dhe

5.5. pasqyrat financiare dhe bilancet e gjendjeve siç kërkohen për vendosjen e pikës filluese për llogaritjen e deklarimit vjetor të tatimit në të ardhurat e korporatave.

6. Përmbajtja e librave dhe regjistrimeve të kërkuara me këtë nen dhe çdo libër dhe regjistrim i



kërkuar, përfshirë ato të mbajtura në format elektronik, përkufizohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 36**

#### **Kërkesat për Libra dhe Regjistrime për bizneset e vogla**

1. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto deri në tridhjetë mijë euro (30,000.00) Euro, i cili nuk zgjedh të përgatisë librat dhe regjistrimet që kërkohen sipas paragrafit 5 të nenit 35 të këtij ligji, mban librat dhe regjistrimet vijuese minimale:

- 1.1. një libër të shitjes në të cilin regjistrohen të gjitha shitjet dhe kthimet;
- 1.2. një libër të blerjes në të cilin regjistrohen të gjitha blerjet dhe kthimet; dhe
- 1.3. një ditar arke që regjistron të gjitha hyrjet dhe daljet në para të gatshme.

2. Përmbajtja e librave dhe regjistrimeve të kërkuara me këtë paragraf dhe çdo libër dhe regjistrim i kërkuar, përfshirë ato të mbajtura në format elektronik, përkufizohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

### **Neni 37**

#### **Deklarimi i tatimeve**

1. Tatimpaguesi, nga i cili kërkohet apo ai i cili zgjedh t'i nënshtrohet tatuarjes në bazë të të ardhurave reale, është i obliguar të përgatis dhe deklaroj të ardhurat, duke përshtatur për qëllime tatimore, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara.

2. Tatimpaguesi dorëzon në ATK deklaratën deri më 31 mars të vitit pasues të periudhës tatimore.

3. Deklarimi bëhet në formularin e paraparë nga ATK dhe baza tatimore do të jetë fitimi i paraqitur në pasqyrat financiare të përpiluara në përputhje me standardet e kontabilitetit, i rritur apo zvogëluar në përputhje me dispozitat e përcaktuara të këtij ligji.

4. Tatimpaguesi, së bashku me deklaratën tatimore, dorëzon në ATK pasqyrat financiare të përpiluara në përputhje me Standardet e Kontabilitetit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

5. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në rast të mbylljes së aktivitetit ekonomik, deklarata vjetore e tatimit dorëzohet në periudhën kur kërkohet çregjistrimi i biznesit.

6. Për zbatimin e këtij neni, Ministri nxjerr akt nënligjor.

### **Neni 38**

#### **Pagesat e tatimit**

1. Sipas këtij ligji, secili tatimpagues çdo tre (3) muaj bënë pagesat e tatimit paradhënie në llogarinë e caktuar nga ATK, në bankën apo institucionin financiar të licencuar nga BQK deri më datat 15 prill, 15 korrik, 15 tetor dhe 15 janar, për tremujorin kalendarik që u paraprin menjëherë këtyre datave.

2. Shuma e secilës pagesë tremujore paradhënie është si në vijim:

- 2.1. tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore deri më tridhjetë mijë euro (30,000.00€), i cili nuk kërkohet ose nuk ka zgjedhur për të dorëzuar deklaratën vjetore sipas nenit 37 të këtij ligji duhet të bëjë pagesat si në vijim për tremujor:



2.1.1. tre përqind (3%) të të ardhurave bruto të pranuar nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori, por jo më pak se tridhjetë e shtatë pikë pesë (37.5) Euro për tremujor;

2.1.2 nëntë përqind (9%) të të ardhurave bruto të pranuar, nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se tridhjetë e shtatë pikë pesë (37.5) Euro për tremujor;

2.1.3. dhjetë përqind (10%) të të ardhurave neto të qirasë për tremujor, të zvogëluara nga çdo shumë e tatimit të mbajtur në burim gjatë atij tremujori në pajtim me paragrafin 3 të nenit 31 të këtij ligji;

2.1.4. nëse një tatimpagues i përshkruar në nënparagrafin 2.1. të këtij neni nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë por tatimpaguesi duhet të dorëzojë deklaratën e këstit tremujor për periudhën kur nuk ka obligim tatimor.

2.2. tatimpaguesit sipas nenit 37, paragrafit 1 të këtij ligji, bëjnë pagesat tremujore si në vijim:

2.2.1. një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura në përputhje me këtë ligj, apo

2.2.2. për periudhën e dytë dhe periudhat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bënë pagesën sipas këtij paragrafi, së paku një të katërtën (1/4) e njëqind e dhjetë përqind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor të periudhës paraprake për periudhën aktuale të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura në përputhje me këtë ligj.

3. Tatimpaguesi i cili ka tejkalluar qarkullimin bruto mbi tridhjetë mijë euro (30,000.00€) është i obliguar që të raportojë të ardhurat dhe të bëjë pagesat në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 35 të këtij ligji dhe nën-paragrafin 2.2 të këtij neni, për periudhën tatimore në të cilën bruto qarkullimi tejkallon tridhjetë mijë (30,000.00) Euro dhe se paku për tri (3) periudha tatimore vijuese.

4. Tatimpaguesi i cili bënë pagesën tremujore paradhënie në pajtim me nën-paragrafin 2.2 të këtij neni, do të bëjë një deklaratë me rregullime përfundimtare të tatimeve dhe paguan shumën e duhur deri më 31 mars të vitit pas periudhës tatimore.

5. Shuma për rregullimin përfundimtar është shuma e përgjithshme e tatimit për periudhën tatimore e caktuar në përputhje me këtë ligj, e zbritur për:

5.1. shumat e mbajtura të tatimit në burim nga të tjerët dhe të paguara në ATK në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale;

5.2. shumat e paguara në këste tremujore;

5.3. krediti i jashtëm tatimor i lejuar sipas këtij ligji.

6. Nëse shumat e paguara, apo kredituara sipas paragrafit 5 të këtij neni janë më të mëdha se shumat e përgjithshme e tatimit e caktuar në përputhje me këtë ligj, tatimpaguesi ka të drejtën e:

6.1. rimbursimit të shumës së tepërt të tatimeve të paguara; apo

6.2. me kërkesën e tatimpaguesit ka të drejtën e bartjes si paradhënie për vitin vijues si dhe për shlyerjen e detyrimeve tatimore në cilindo lloj tatimi dhe kontribut pensional.

7. Nëse pagesa paradhënie nuk është bërë me kohë apo është bërë në shumën që është më pak se ajo e kërkuar, ATK aplikon një ndëshkim në një shumë të barabartë me shkallën e interesit që është në fuqi në kohën kur pagesa paradhënie ka qenë obligative për t'u bërë. Nuk do të ketë shtesa tjera në tatim, për pagesat paradhënie me vonesë apo të pamjaftueshme. Nëse pagesat ose pagesat e korrigjuara të kësteve tremujore bëhen në datën apo para datës së duhur dhe deklarata me rregullime përfundimtare ose deklarata përfundimtare me rregullime të korrigjuara është bërë siç parashihet me paragrafin 4 të këtij neni, atëherë nuk kërkohet interes apo ndëshkim për pagesë të pamjaftueshme, nëse:

7.1. dallimi ndërmjet shumës së duhur për çdo këst dhe shumës së paguar në çdo këst nuk tejkalon njezetë përqind (20%) të shumës së duhur, apo

7.2. pas periudhës së parë tatimore të tatimpaguesit, shuma e paguar në çdo këst është së paku dhjetë përqind (10%) më shumë se një e katërta (1/4) e detyrimit tatimor në deklaratën tatimore për periudhën tatimore paraprake:

7.2.1. nëse ATK kryen një kontroll të ndonjë viti dhe bënë një rregullim të tatimit të atij viti mbi njezetë përqind (20%), lirimi nga ndëshkimi i paraparë në nënparagrafin 7.2. të këtij neni, nuk aplikohet në kërkesat për pagesë paradhënie për periudhën tatimore pasuese.

7.3. për periudhën e parë të afarizmit, tatimpaguesi nuk penalizohet nëse shuma e pagesave paradhënie tremujore përfshirë këstin e katërt tremujor, është tetëdhjetë përqind (80%) apo më shumë e tatimit përfundimtar obligativ për atë periudhë tatimore;

7.4. tatimpaguesi që ka pasur humbje në deklaratën e tatimit në të ardhurat e korporatave të vitit paraprak nuk ka të drejtë të përdorë dispozitat e nën-nënparagrafit 2.2.2 të këtij neni në kryerjen e pagesave paradhënie për vitin aktual. Tatimpaguesi i tillë duhet të kryejë pagesat paradhënie në përputhje me dispozitat e nën-nënparagrafit 2.2.1. të këtij neni;

7.5. ndëshkimi që ngarkohet sipas këtij neni aplikohet vetëm në shumën e nënpaguar nga data obligative e kësteve paradhënie deri në datën e përshkruar në paragrafin 4 të këtij neni për të bërë rregullimin përfundimtar për periudhën tatimore.

8. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.

## KAPITULLI X DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 39 Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit

1. Ministri nxjerr akt nënligjor të kërkuar dhe referuar me këtë ligj, brenda periudhës prej gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, afati prej gjashtë (6) muaj nuk aplikohet për nxjerrjen e aktit nënligjor të përcaktuar në nenin 8, paragrafin 3 të këtij ligji.

**Neni 40**  
**Dispozitat shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, miratuar nga Kuvendi me datë 22 korrik 2015 dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 24, më 18 gusht 2015.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, vazhdojnë të zbatohen nga ATK-ja në shqyrtimin e çështjeve tatimore që i takojnë periudhave përkatëse.

**Neni 41**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L-105**  
**27 qershor 2019**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-147-2019, datë 12.07.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**

